

VESEL ISLAMI

TIPOLOGJIA E ROMANIT PËR FËMIJË NË KOSOVË

821.18-93-31.09

Abstrakti: Mbështetur në disertacionin e doktoratës që kam përzgjedhur ta punoj në fushën e letërsisë për fëmijë, përkatësisht mbi romanin për fëmijë në Kosovë, atëherë zgjedha një temë të tillë.

Mendoj se tipologjia e romanit për fëmijë në Kosovë është e begatë, sidomos kur kemi parasysh faktin se një numër i konsideruar i shkrimtarëve janë marrë me kultivimin e këtij lloji të gjinisë së prozës, nëpërmjet së cilës kanë sjellë; tema, ide, motive, personazhe, karaktere, situata, etj., etj., duke pasuruar letërsinë për fëmijë në vendin tonë.

Nëpërmjet kultivimit të romanit është krijuar shprehi e leximit dhe kulturës tek fëmijët, për vetë faktin se një pjesë e konsideruar e këtyre romaneve kanë shërbyer dhe shërbejnë si lëktyra shkollore në arsimin fillor.

Këtë punë studimore mendojmë ta realizojmë nëpërmjet metodës së analizës dhe interpretimit, duke synuar që gjithnjë të punojmë në qasje ndaj tekstit, mirëpo, të gërshetojmë edhe metodën krahasimtare, sidomos kur i njëjti tip romani kultivohet tek dy, tre apo më shumë shkrimtarë, pra, të vëhen në raporte krahasimi.

Pasi interesimet e studiuesve tanë për ta hulumtuar dhe studiuar këtë fushë janë të pakta në vendin tonë, ndaj, mendojmë që sado pak puna jonë të kontribuojë në kuadër të studimeve kritiko-letrare, në fushën e letërsisë për fëmijë në Kosovë.

Fjalë kyçe: Letërsi për fëmijë, roman, tipologji, interpretim.

Abstract: "The typology of a Child's Novel in Kosovo"

Based on the doctoral dissertation I have chosen to work in the field of literature for children, respectively on the novel for children in Kosovo, then I chose such a topic.

I think the typology of the novel for children in Kosovo is prosperous, especially when we consider the fact that a number of writers have been involved in cultivating this kind of prose genus through which they have brought; Topics, ideas, motives, characters, characters, situations, etc., enriching children's literature in our country.

Through the cultivation of the novel, the habit of reading and culture is created in the children, by the fact that a substantial part of these novels have served and serve as literacy in elementary education.

We are thinking of doing this research work through the method of analysis and interpretation, aiming at always working on the approach to the text, but also combining the comparative method, especially when the same type of novel is cultivated in two, three or more writers, be put into comparative reports.

Since our researchers' inquiries to study and study this area are scarce in our country, so we think that our work contributes to the literary and literary studies in the field of children's literature in Kosovo.

Key words: Children's Literature, novel, typology, interpretation.

Interesimet e studiuesve tanë në fushën e studimeve të letërsisë shqipe për fëmijënë Kosovë janë shumë pak të orientuara në këtë drejtim. Mbështetur mbi këtë fakt kemi shprehur gatishmërinë dhe përkushtimin tonë që sado pak të kontribuojmë mbi këtë çështje. Përzgjedhëm romanin për fëmijë për arsye se romani si

gjini letrare përfshinë një koncept të gjerë të mendimit, ideve, motiveve dhe temave, e tërë këtë duke e bërë sipas një ndarjeje mbi *tipologjinë*.¹

Nëse i referohemi historisë së letërsisë për fëmijë në Kosovë, shohim se romani si zhanër i gjinisë së prozës nuk është edhe aq i hershëm. Kultivimi i tij nis në vitin 1959 me shkrimtarin Rexhep Hoxha. Pra, fillet e para të këtij zhanri janë dhënë me romanin “Lugjet e Verdha”, të shkrimtarit të lartpërmendur, si tekst që i takon tipit të romanit përrallë.

Thujse është vazhduar bukur një kohë të gjatë kultivimi i romanit përrallë në letërsinë vendit tonë e veçanërisht si thesar që u ka ndihmuar shkrimtarëve tanë në kultivimin e këtij tipi romani është pa dyshim edhe folklori. Përmes formave të interpretimit të përrallave janë interpretuar ide të rëndësishme që kanë luajtur rol poashtu edhe në edukimin e brezave dhe gjeneratave të reja. Idetë e tilla që kanë buruar nga pasuria e krijimtarisë popullore, përkatësisht e folklorit përbëjnë një thesar të çmuar në vete. Mbështetur gjithnjë mbi përvojat jetësoreidetë e tilla janë skalitur në mendjen e popullit ku gjithherë në vete kanë bartur mesazhe e porosi të rëndësishme, të cilat ndikojnë edhe në ruajtjen e vlerave mbi tradita e zakone kombëtare. *Problemi mbi vlerën pedagogjike të përrallës popullore, gjatë shekullit XIX dhe shekullit XX, ka qenë një tribunë lufte e ashpër letrare-ideologjike midis shkrimtarëve, kritikëve, pedagogëve dhe ideologëve përparimtarë*.²

Shkrimatërt e letërsisë për fëmijë për ta kultivuar tipin e romanit përrallë shpeshherë janë mbështetur në përrallat e vjetra shqiptare, të përcjellura brez më brez e të konsideruara si vlera të mirëfillta për ruajtjen dhe ripërtëritjen e traditës. Mirëpo, gjithmonë kur stili artistik gërshetohet me atë popullor dhe përmes mjeshtërisë së veçantë formësohet edhe në aspektin e strukturës edhe si formë, teksti arrinë të marrë primatin e një vepre të rëndësishme letrare. Ndonëse jo vetëm shkrimtarët e brezit të hershëm që kanë kultivuar letërsinë për fëmijë në Kosovë kanë qenë të orientuar në kultivimin e romanit përrallë, por vazhdimin e traditës e kanë ndjekur edhe shkrimtarët të gjeneratave të mëvonshme ku edhe ata kanë shkruar romane për fëmijë. Si duket është jo e lehtë të dalja nga tradita, prandaj pothuajse në krijimtarinë e secilit romanicer për fëmijë vërejmë këto ndikime që në mënyrë direkte apo tërthorazi aty-këtu, kanë prekur elemente përrallore në trajtimin e temave në romanet e tyre.

Me rritjen e numrit të shkrimtarëve tanë që kanë kultivuar letërsinë për fëmijë, e veçanërisht romani si gjini letrare, janë shtuar edhe interesimet e tjera dhe kanë arritur të kultivojnë edhe romane që i takojnë tipave të tjera, e në këtë mënyrë ta begatojnë tipologjinë e romanit për fëmijë në letërsinë shqipe në Kosovë. *Megjithëse romani ynë është i ri në moshë, ai është i larmishëm, me stile nga më të ndryshmet, gjë që dëshmon me origjinalitet e larmi. Ai krijoi një galeri të gjerë me personazhe fëmijësh të zgjuar e të shkathët, me botë të pasur shpirtërore, të sigurtë e punëtorë*.³

Pa dyshim që ndikimi i rrethanave objektive, marrëparasysh proceset e vështira mes të cilave ka kaluar vetë populli ynë, ka bërë të mundur të shfaqen shenja ndikimi edhe në krijimtarinë letrare tek shkrimtarët në përgjithësi, por edhe tek ai i rangut për fëmijë. Në këtë kontekst do ta përmendim tipin e romanit historik, i cili jo edhe aq pak trajton tema me tematikë nga historia e me personazhe poashtu historikë. Kultivimi i tipit të tillë të këtij romani në letërsinë shqiptare për fëmijë në vendin tonë, ka shërbyer në edukimin e brezave të rinj, për t’ua mësuar të kaluarën dhe peripetitë e rrugëtimet e vështira deri në këtë pikë ku edhe ndodhemi.

Prandaj është kjo periuedhë e gjatë që përbrenda vetës gërsheton tema të shumta dhe personazhe poashtu të shumtë, ku në secilën epokë historike thujse kemi mundësinë të gjejmë interpretime të ndryshme

¹Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë 2006, fq. 1091

²Bedri Dedja, *Burimet e letërsisë shqipe për fëmijë*, Rilindja, Prishtinë 1978, fq. 17

³Astrit Bishqemi, *Historia e letërsisë shqiptare për fëmijë e të rinj*, Dy lindje dhe dy Perëndime, Tiranë 2008, fq. 441

artistike të së kaluarës sonë historike. Temat e tilla janë bërë me interes tek një numër i shkrimtarëve dhe kanë arritur që para lexuesve të vegjël të prezantojnë një pjesë të historisë. Meqenëse, romanet hyjnë edhe në kuadër të lëktyrave shkollore dhe si të tilla bëhen obligim që nxënësit duhet t'i lexojnë, atëherë kjo është edhe një plotësim i pjesës së mësimin të historisë së popullit shqiptar. Pasi niveli për të cilin po flasim i takon nivelit të letërsisë për fëmijë, atëherë temat e tilla nga historia janë trajtuar me një mjeshhtëri të veçantë, jo tamam me përshkrimin e karaktereve të egra e të forta të personazheve, por me një ton më të butë, për t'ia përshtaur gjithmonë nivelit që i dedikohet për lexim. Përmes tipit të romanit historik fëmijët tanë do të paisën me njohuri më të mëdha rreth së kaluarës historike, do ta plotësojnë bagazhin e tyre informative intelektual dhe gradualisht në rrugëtimin e tyre mësimorë do të përforcohen me njohuri të reja. Mësimi i historisë në këtë mënyrë luan edhe rolin e tij të veçantëpoashtu edhe në mishërimin e nxënësve, mbi forcimin ideoemocional të tyre, kur ata mund të krijojnë idole të veçanta mbi heronj apo ngjarje të veçanta dhe të identifikohen me ta.

Me temë historike janë ndërtuar shumë romane për fëmijë, të cilat kanë ndihmuar në edukimin ideoemocional të lexuesve. Në këto vepra kërkohet vërtetësi dhe konkretësi historike. Gjithashtu, problemet që ngrihen janë trajtuar në mënyrë të tillë që t'u bëjnë jehonë shqetësimeve të kohës kur janë shkruar nga autorët.¹

Tipin i romanit historik në letërsinë shqipe për fëmijë në Kosovë mund të ndajmë në dy pjesë. Në pjesën e parë janë të përfshira romanet të cilat përqendrohen më shumë në tematikën historikeqë nga epoka e lavdishme e Skënderbeut e deri në shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë. Në këtë pjesë hasim në karakteret e personazheve të mëdhenj e të ndritshëm të historisë kombëtare shqiptare, duke trajtuar ngjarje të veçanta që shquhen në historinë e popullit shqiptar, duke reflektuar një pjesë të krenarisë tonë si komb. Gjithnjë në trajtimin e këtyre temave janë prezent personazhë të veçantë që historikisht përmenden për kontributin e tyre kombëtar e patriotik, si të tillë ngjallin kreshërinë e lexuesve të vegjël dhe identifikimin e tyre si heronj të vërtetë, me të cilët lexuesit e vegjël shpeshherë provojnë të identifikohen me ato karaktere.

Në pjesën e dytë edhe pse dukshëm me pak e trajtuar zën fill ngjarjet që ndërlidhen me fillimin e luftës së fundit në Kosovën e viteve 1998-1999, përfundimin e saj dhe fitorën e lirisë. Koncepti i luftës në këto romane është i vështirë për t'u definuar si i tillë. Meqenëse është një koncept i ndjeshëm për nivelin e kategorisë së lexuesve, është provuar përmes një mjeshhtëri ku me mvëshjen e figuracionit stilistik dhe improvizimin e ngjarjeve të thuren motivet e kësaj peiudhe të dhembshme, por njëkohësisht edhe krenare. Pra, në këtë pjesë përcillet një ndjenë e veçantë e krenarisë sonë për sakrificën e madhe, duke kaluar tërë ato vuajtje e përjetime si peripeti të mëdha të vetë popullit, por që në fund rezulton me një shpërblim të shumëpritur me dekada, e cila është vetëliria. Në këtë mënyrë trajtimi i temave që pasqyrojnë një epokë më të freskët të shoqërisë sonë është më e ndjeshme edhe në procesin e leximit dhe interpretimit të saj.

Motive të rrethanave të vështira të krijuara shpeshherë në proceset e jetës kanë shtyer shkrimtarët për fëmijëqë të trajtojnë edhe romane me tema sociale, ku si të tilla mund t'i konsiderojmë romane të tipit social. Mbështetur mbi realitetin e jetës nga rrethanat ekzistuese nëpër të cilat shoqëria jonë ka kaluar dhe është ballafaquar, shumë prej atyre situatave e motiveve janë bërë edhe tema trajtimi në romanet e këtij lloji.

Në këto romane shpeshherë është munduar të nxirret një pasqyrim real i situatave, ngjarjeve, nëpër të cilat ka kaluar shoqëria, duke vënë në pah vështirësitë dhe përparësitë e kohës. Pra, vërejmë motive të

¹ Astrit Bishqemi, *Historia e letërsisë shqiptare për fëmijë e të rinj*, Dy lindje dhe dy Perëndime, Tiranë 2008, fq. 442

ndryshme që janë trajtuar në romanet për fëmijë, ku nganjëherë janë përmendur aspektetë cilat më shumë reflektojnë vështirësi në jetën shoqërore, por edhe të tilla romane me motive inkurajuese që kanë reflektuar më shumë anët pozitive. Në kuadër të këtyre romaneve janë trajtuar edhe motive që kanë të bëjnë me konsolidimin dhe organizimin e shoqërisë në përgjithësi. Në këtë kontekst kanë gjetur zbatim edhe fenomene të rëndësishme të cilat ndërlidhen me ballafaqimin e problemeve të përditshmërisë, ku janë prekur edhe motivi i magjisë si bestytini që ka has në rrethin e shoqërisë sonë e madje me një prezencë bukur të konsiderueshme që si nëntemë zën vend në disa romane të autorëve të ndryshëm. Pastaj janë prekur edhe elementet e tjera mjaftë me rëndësi që ndërlidhen me karakteristikat e veçanta të traditës, dokeve e zakoneve shoqërore. Janë përmendur fenomeni i gjakmarrjes e hakmarrjes si dukuri, të cilat tradicionalisht kanë gjetur zbatim nga brezat e mëhershëm. Në tipin e tillë të romaneve *lexuesit e vegjël kanë rastin të njihen me një plagë të rëndë kombëtare - hakmarrjen në trojet tona*¹, mirëpo me ndryshimin e qasjeve, tashmë gjeneratat e reja nuk aplikojnë zbatimin e këtyre fenomeneve të egra shoqërore.

Veçanërisht një prej motiveve që ka përcjellë shkrimtarë të shumtë të letërsisë për fëmijë në vendin tonë është ai i kurbetit. Tema e kurbetit është trajtuar në mënyra të ndryshme nga shkrimtarë të ndryshëm, gjithnjë përmes këndtrajtimit social. Vëhen në pah vështirësitë sociale e ekonomike, kërkesat e shumta që shfaqen para jetës familjare dhe në pamundësi realizimi të të gjitha atyre kërkesave vjen deri tek marrja e vendimeve pa dëshirë dhe vullnet të personazheve, por më shumë si obligim dhe detyrim familjar. Përmes kësaj teme shfaqen edhe imazhe personazhesh që reflektojnë dhembje njerëzore, merzinë dhe mallin. Rritja e fëmijëve pa praninë e prindërve, e më pas përshkrimi i situatave nëritakimet e tyre është i ndjeshëm dhe shumë emocional për t'u përjetuar edhe nga pozicioni i lexuesit.

Ndoshta edhe për shkak të moshës së cilës i dedikohet romani për fëmijë, do të ndërlidhemi më veçanërisht me tipin e romanit që reflekton shtresime pedagogjike, didaktike e arsimore.

Janë të shumtë shkrimtarët për fëmijë në Kosovë, që me romanet e tilla reflektojnë dukuri pozitive mbi edukimin mundohen të trajtojnë çështje me interes, të cilat do luajnë rolin e tyre të rëndësishëm në formimin intelektual e njerëzor të fëmijëve tanë. Përmes ideve e motiveve të veçanta nga autorë të ndryshëm është arritur të prekën disa specifika, të cilat reflektojnë rëndësinë e domosdoshme në procesin e edukimit dhe arsimimit. Në këtë kontekst janë trajtuar tema me interes të përgjithshëm, që flasin për rëndësinë e këtij procesi, format se si të rrugëtohet drejt tij dhe arritja e krijimit të idealeve të caktuara, të cilat ngrisin motivin për vetë nxënësin dhe bëjnë që fëmijët të jenë gjithëherë në kërkim të mundësive për t'u edukuar e arsimuar, në mënyrë që të jenë të suksesshëm në jetë e veprimtari.

Romanet e tipit që trajtojnë shtresimet pedagogjike, didaktike janë bukur të shumta në letërsinë për fëmijë në Kosovë, dhe si të tilla janë kultivuar nga shkrimtarë të shumtë që i takojnë brezave të ndryshëm. Fenomeni i edukimit dhe arsimimit është konsideruar shumë i rëndësishëm nga motivi që ka përcjellë këtë tip të romanit, aty është provuar të reflektohet gjithnjë e më shumë procesi i edukimit dhe arsimimit, si një prej qëllimeve parësore dhe më të rëndësishme në jetën e secilit individ.

Të trajtuara përmes formave të ndryshme, nganjëherë edhe me indikacione autobiografike, apo me personazhe që kanë zvendësuar karakterin e vetë shkrimtarit janë thurur tematë tilla gjithnjë me mesazhe dhe porosi të qarta për një edukim sa më cilësor dhe meritator. Megjithatë, proceset e tilla nëpër të cilat duhet kaluar dhe arritur sukseset e dëshirueshme në formimin intelektual janë me mjaftë vështirësi dhe peripeti, ndaj si të tilla janë dhënë edhe përshkrimet e situatave me tone ndjeshmërie, ku rruga që të dërgon drejt suksesit dhe një të ardhmeje të dëshiruar nuk është e lehtë për t'u rrugëtuar. *Romani ynë për fëmijë nuk ka mundur të gëzojë respekt të duhur e as ta kryejë funksionin e vetë shoqëror, sikur në të të*

¹ Sadik Bicaj, *Vështrime letrare*, Era, Prishtinë 2001, fq. 44

*manifestohej vetëm karakteri edukativ, pasi veprat që në të cilat dominon theksi edukativ kurse lihen pas dore kërkesat e tjera, sado që të jenë trajtuar bukur ato megjithatë do të jenë të njëanshme.*¹

Në këtë kontekst vështirësitë e edukimit dhe arsimit janë pasqyruar edhe përmes tablove duke ju referuar kohës së vështirë politike në të cilën gjendej shoqëria jonë. Në mënyrë metaforike provohen të prezantohen situata të caktuara që përcjellin vështirësitë e veçanta të personazheve të veçantë në rrugëtimin e tyre drejt dijes dhe edukimit, ku reflektohen momente të ndjeshme dhe sfiduese.

Meqenëse niveli i letërsisë për të cilën kemi parashtruar problemin kryesor i takon rangut të fëmijëve dhe humori si krijimartistik që mund të prezantohet edhe përmes zhanrit të romanit, në këtë rast është shumë i zbehur. Nuk mund të themi se nuk hasim në situata e moment që prezantojnë pjesë humori përbrenda një romani, por të përcillet fund e krye tema e një romani, apo më konkretisht ta konsiderojmë si roman të tipit humoristik një tekst të tillë kemi raste të pakta. Megjithatë, nuk mund të themi se nuk kemi fare, përderisa Ymer Shkreli me romanin “Bali Katravella”, krijon tipin e romanit historik për fëmijë në vendin tonë. Edhe pse është tekst bukur i hershëm diku nga fund i viteve të shtatëdhjeta, shkrimtarët e tjerë nuk i ka tërhequr motivi për të kultivuar atë tip romani, ndaj edhe nuk kanë provuar të sjellin diçka të re në këtë drejtim.

Një ndër romanet që zën vend të konsiderueshëm në letërsinë për fëmijë në Kosovë është edhe tipi i romanit aventurë. Shkrimtari, Ymer Elshani, është i pari që në vendin tonë ka filluar së kultivuari këtë tip të romanit, duke i dhuruar një pasuri të begatë letërsisë shqipe për fëmijë në përgjithësi e gjinisë së prozës me zhanrin e romanit në veçanti. Temat që trajtohen nëpër këto romane qoftë të shkrimtarit në fjalë apo edhe tek shkrimtarët e tjerë pas tij janë me motive të shumta. Mund të hasim prej atyre që kanë motive për lojën, për shetitjen, përjetimin e ngjarjeve të veçanta dhe shumë motive të tjera që ngrisin nivelin e përjetimeve të kënaqësisë emocionale të fëmijëve, duke reflektuar një ton emocionaliteti në botën shpirtërore/psikologjike, veçanërisht të kryepersonazheve. Tipin e tillë të romanit e hasim mjaftë të kultivuar nga shkrimtarë të ndryshëm, të artikuluar sipas stilit krijues me ide e motive artistike, por gjithnjë duke u munduar që gërshetimi të bëhet edhe përmes botës reale faktike, ku personazhet janë përzgjedhur të tillë.

Në këtë mënyrë prezantimi i tipit të këtij romani para lexuesve të vegjël do luaj rol të rëndësishëm edhe në jetën e tyre, në formimin e tyre dhe gjykimin e gjërave në përgjithësi. *Sensibilizimi i fëmijës me ide të dobishme për realitetin dhe përditshmërinë, bartja e bukurisë dhe zgjimi emotiv e racional, si dhe krijimi i ideve të reja për jetën, është një tendencë për një relaksim emotiv të fëmijës gjatë ballafaqimit me fenomene e situata jetësore të veshura me aventura.*² Si të tilla këto romane ngjallin dëshirën për lexim të vazhdueshëm tek fëmijët, mishërohen me përjetimet e veçanta të personazheve nëpër situata të caktuara dhe secili prej lexuesve të tekstit thuhet se ka dëshirë të gjendet në pozicione të tilla, në përjetimin e ndjenjave që sjellin kënaqësi shpirtërore.

Sado që mund të flasim për pasurimin e tipologjisë së romanit për fëmijë në Kosovë, prapë se prapë mund të themi se kemi mangësi në arritjen e zgjerimit të përgjithshëm të tij. Bie fjala tipin e romanit sentimental nuk e kemi të kultivuar si lloj nëvete. Edhe pse shkrimtari i mirënjohur për fëmijë Gani Xhafolli, në romanet e tij ka prekur ndjeshëm motivin sentimental, por prapë zhvillimi i ngjarjeve nuk ka ecur vetëm përmes së njëjtës linjë narrative, por ka gërshetuar situata që trajtojnë edhe motive të tjera, e sidomos ato me shenja autobiografike.

Me këtë rast mund të ndërlihem edhe me tipin e romanit autobiografik, i cili si i tillë prapë nuk mund të konsiderohet zhanër në vete, por vërehen shenja autobiografike te disa shkrimtarë, që përmes artikulimit

¹Agim Deva, *Romani ynë për fëmijë*, Rilindja, Prishtinë 1977, fq. 36

²Qibrrije Demiri-Frangu, *Letërsia për fëmijë*, Rozafa, Prishtinë 2011, fq. 126

të temave në romanet e tyre prezantojnë një pjesë të biografisë së tyre në jetë dhe në vepër. Në mënyrë më të drejtpërdrejtë këtë mund ta hasim në romanet e Gani Xhafollit, sidomos në raste të caktuara kur edhe personazhet e përzgjedhur në tekstet e tij, respektivisht emrat e tyre janë të ngjashëm me disa prej emrave të fëmijëve të tij. Përveç aspektit identifikues të emrave vërehen edhe indikacionet që shfaqin botën e fëmijëve të vegjël, ku prezantojnë talentet e tyre intelektuale dhe dëshirat e kërkesat drejtuar shkrimtarit pikërisht për kultivimin e romaneve të radhës. Pra, indikacionet e tilla që shfaqen në pjesët e tekstit të romaneve janë shenja të qarta që reflektojnë një pjesë të autobiografisë së vetëshkrimtarit. Edhe tek shkrimtarë të tjerë hasim në shenja autobiografie, por në përmasa më pak të prezantuara, ndërsa për nga ana e karakterit, paraqitjes dhe rolit e funksionit të personazhit në tekst identifikohet me vetë autorin pa dyshim.

*Përveç asaj që tipi i romanit prezanton ide, motive e tema në vete, është pa dyshim edhe prania e personazheve përbrenda atyre teksteve një prej përbërësve të rëndësishëm. Pothuaj të gjitha personazhet e romanit tonë i përshkon ndjenja e kolektivitet, e dashurisë së sinqertë, e shoqërimit dhe miqasimit reciprok midis fëmijëve.*¹ Gjithmonë duke marrë parasysh tipin e romanit i cili kultivohet për lexuesit e vegjël, duhet edhe inkorporimi i personazheve të jetë i arsyeshëm.

Pasi fjala është për letërsinë për fëmijë, sa i përket kategorisë së personazheve që janë pjesë e romaneve të autorëve në përgjithësi hasim në karaktere të ndryshme. Përfshirë kategorinë e vetë fëmijëve si personazhë, të cilët në raste të caktuara kanë misionet e caktuara, apo përballja me sfidat, përjetimi i aventurave etj., etj. Mirëpo, jo rrallëherë hasim edhe në personazhe që i takojnë kategorisë së kafshëve, shpezëve, bimëve etj. Karakteret e tilla të krijuara nga ana e mjeshtërisë artistike të autorit prezantojnë një pjesë të veçorive dhe specifikave të vetë personazheve që në realitetin e përgjithshëm mund t'i identifikojmë me të tilla tipare. Në këtë mënyrë ofrohet poashtu një pjesë e njohurive të përgjithshme mbi nxënësit që të njihen me gjerësisht me specifikat e secilit personazh që për moshën e tyre mund të jenë ende të panjohura.

Literatura

Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë 2006

Bicaj, Sadik: *Vështrime letrare*, Era, Prishtinë 2001

Bishqemi, Astrit: *Historia e letërsisë shqiptare për fëmijë e të rinj*, Dy Lindje dhe dy Perëndime, Tiranë 2008

Bishqemi, Astrit: *Autorë të letërsisë shqiptare për fëmijë e të rinj*, Dy Lindje dhe dy Perëndime, Tiranë 2009

Dedja, Bedri: *Burimet e letërsisë shqipe për fëmijë*, Rilindja, Prishtinë 1978

Demiri-Frangu, Qibrije: *Letërsia për fëmijë*, Rozafa, Prishtinë 2011

Deva, Agim: *Romani ynë për fëmijë*, Rilindja, Prishtinë 1977

Grillo, Odhise: *Nëpër faqet e letërsisë sonë për fëmijë*, Naim Frashëri, Tiranë 1986

¹ Agim Deva, *Romani ynë për fëmijë*, Rilindja, Prishtinë 1977, fq. 96